



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF), e mbajtur më 16.12.2022, me fillim në ora 10:00. Mbledhjen e kryesoi kryesuesi i kuvendit **Defrim Kafexhiu**.

Kryesuesi – Fillimisht më lejoni të ju përshëndes të gjithëve, nënkryetarin **Fatmir Iska**. Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorë të drejtorive, zyrtarë komunal dhe të gjithë ju të pranishëm. Faleminderit shumë për pjesëmarrjen. E hapim mbledhjen e 11-të të Komitetit për Politikë dhe Financa.

Në konsultim me kryetarin e komunës kemi përgatitur këtë rend dite;

REND DITE

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;
2. Shqyrtimi i raportit mbi realizimin e planit për vitin 2022 si dhe informatë mbi planin vjetor të prokurimit publik 2023;
3. Shqyrtimi i Raportit të Punës të Kryetarit të Komunës për vitin 2022;
4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për Planin e Punës të Kryetarit të Komunës së Rahovecit për vitin 2023;
5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për Planin e Punës të Kuvendit Komunal për vitin 2023;
6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për Planin e Punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2023;
7. Shqyrtimi i propozim-vendimit për Planin e Vlerësimit të Rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera;
8. Shqyrtimi i propozim-vendimit për Planin e Transportit Rrugor 2022 – 2027;
9. Shqyrtimi i propozim-vendimit për Planin e Mobilitetit Urban 2022 – 2027;
10. Shqyrtimi i propozim-vendimit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2023;
11. Shqyrtimi i propozim-vendimit për dalje në konsultim publik të Planit Zhvillimor Komunal, PZHK;
12. Shqyrtimi i propozim-vendimit për miratimin e simbolit përkujtimor të gjenocidit në Kosovë;
13. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr.263/22, i datës: 25.01.2022, për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;
14. Shqyrtimi propozim-vendimit për shpalljen në interes të përgjithshëm të parcelës në Xërxë P-01041-1 – Xërxë;
15. Shqyrtimi i vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 338/22 i datës 29.06.2022 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër;
16. Shqyrtimi i vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 341/22 i datës 29.06.2022 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;
17. Të ndryshme.

Pikë shtesë

1. Shqyrtimi raportit mbi regjistrimin dhe vlerësimin e dëmeve në anvisëri, ekonomi familjare dhe biznese, të shkaktuara nga vërshimet e shiut me datë: 17 shtator 2022.

Kryesuesi – Përshëndetje për të gjithë, ia uroj pozicionin e ri drejtoreshës për Punë Emergjente zonjës Besë Bytyqi. **Pika 11** e rendit të ditës tërhiqet nga rendi i ditës sepse sot e kemi seancën e jashtëzakonshme pikërisht për këtë pikë të rendit të ditës. Poashtu e kemi edhe një pikë shtesë të rendit të ditës: - *Shqyrtimi i raportit mbi regjistrimin dhe vlerësimin e dëmeve në anvisëri, ekonomi familjare dhe biznese, të shkaktuara nga vërshimet e shiut me datë: 17 shtator 2022*. Atëherë po e vendosim në votim që ta përfshijmë në këtë rend dite. Kush është për?... Me shumicë votash shtohet edhe kjo pikë në rend të ditës.

Burim Krasniqi – Faleminderit kryesues. Përshëndetje ekzekutiv, kolegë, të gjithë të pranishëm. E kam një pyetje për drejtorin e shërbimeve publike ose urbanizmit, varet se cili e ka çështjen e mobilitetit dhe transportit. Drejtor, a mos ndoshta është pak që në 17 pika të rendit të ditës të diskutojmë për planin e mobilitetit të komunës së Rahovecit, ose është dashtë me qenë në një seancë kur kemi më pak pika të rendit të ditës dhe ku mund të diskutojmë më gjerësisht, sepse mendoj që është goxha temë e rëndësishme së paku për mua (inxhinier i komunikacionit) që në mesin e 17 pikave ta diskutojmë Planin e Mobilitetit. Më mirë do të ishte në një ditë të caktuar, me më pak pika ta kemi një prezantim me sllajde. Unë e kuptoj që ne jemi asamble dhe nuk jemi profesionist të të gjitha fushave, dikush ndihet më mirë në transport, tjetri në ekonomi e tjetri në çështje ligjore, por së paku temat e rëndësishme si kjo është mirë të diskutohen më shumë dhe nëpër seanca ku ka më pak pika të rendit të ditës. Nuk besoj që është urgjente, më mirë ta bëjmë mirë sesa shpejtë.

Përparim Krasniqi – Faleminderit kryesues. Përshëndetje për të gjithë anëtarët e KPF-së. Po Burim është urgjente sepse granti i performancës i ka kriteret dhe afatet e caktuar që duhet t'i kalojmë këto plane. Siç e dini në vitin 2021 ka kaluar Planin e Mobilitetit dhe këtë plan e kemi punuar në 2022 dhe duhet ta kalojmë, përndryshe nuk mund të gradohemi në vitin e ardhshëm në çoftëse shtyhet kjo pikë e rendit të ditës. E kemi pas edhe në diskutim publik, ta kam bërë edhe një ftesë zyrtare që të na ndihmohet në këtë aspekt. Është afat ligjor që kjo pikë e rendit të ditës nuk mund të largohet.

Burim Krasniqi – Drejtor, unë kam menduar që kontribut të mjaftueshëm jap në asamble komunale. Nëse tentojmë të kalojmë diçka formalisht, pa e trajtuar mirë, është gabim. Sipas informacioneve që i kam, raporti i kualifikuar i auditorit e heq nga gara komunën e Rahovecit për grant të performancës. Kështu që nuk qëndron ajo që po e thua, por ne e shtyejmë tutje nuk është problem.

Kryesuesi – Faleminderit. Atëherë po vazhdojmë me miratimin e rendit të ditës. Kush është (për) miratimin e rendit të ditës?... Me shumicë votash miratohet rendi i ditës për sot.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;

Kryesuesi – A ka dikush prej anëtarëve të KPF-së ndonjë koment rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është për?... Me shumicë votash aprovohet edhe procesverbali.

2. Shqyrtimi i raportit mbi realizimin e planit për vitin 2022 si dhe informatë mbi planin vjetor të prokurimit publik 2023:

Astrit Mullabazi – Faleminderit i nderuar, unë jam Astrit Mullabazi – zyrtar përgjegjës i prokurimit. Sa i përket planifikimit paraprak të prokurimit për 2023 dhe duke pasur parasysh që komuna ka aprovuar buxhetin për vitin 2023, duke u mbështetur në nenin 8-të paragrafi 1 të ligjit të prokurimit; Sa i përket planifikimit paraprak, duhet të dorëzohet me shkrim tek zyrtari kryesor administrativ i autoritetit kontraktues apo te kryetari i komunës, jo më larg se 30 ditë para fillimit të vitit fiskal. Me datë 30.11.2022 është bërë planifikimi paraprak i prokurimit për vitin 2023 dhe ia kemi dërguar kryetarit të komunës. Ky planifikim përfshin furnizimet, shërbimet dhe punët që do të realizohen gjatë vitit 2023. Planifikimi përfundimtar i prokurimit për 2023 sipas ligjit të prokurimit publik bëhet 15 ditë pas miratimit të buxhetit në nivel qëndror. Sa i përket raportit vjetor për kontratat e nënshkuara publike, raporti nuk është final për shkak se raporti final dërgohet në KRPP (Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik) jo më larg se 30 janari i vitit 2023.

Gjithsej procedurat e prokurimit për vitin 2023 janë 61. Vlera e tyre e parashikuar është 14.890.732euro, ndërsa vlera e kontratave të nënshkruara është 6.359.000euro.

Kryesuesi – Faleminderit Astrit. Një pyetje; Sipas planit të prokurimit publik, si përfshihet kuvendi komunal?... Ose a përfshihet?

Astrit Mullabazi – Kuvendi komunal nuk përfshihet, nevojat që janë për kuvendin komunal janë brenda drejtorisë së administratës.

Burim Krasniqi – Faleminiderit menaxher. Një pyetje: A është ky plan i prokurimit i harmonizuar komplet me departamentin e financave sa i përket kostove?... A ka mbulueshmëri financiare?

Astrit Mullabazi – Ne e kemi dërguar te njësitë kërkuese, te çdo drejtori përkatëse për ta bërë planifikimin paraprak të prokurimit. Drejtoritë përkatëse janë konsultuar me drejtorinë e financave për projektet vlera e të cilave është e parashikuar për shpallje.

Afrim Limani – Përhëndetje për të gjithë. Një përgjigje për Burimin: Plani i prokurimit është i bazuar me planifikim të buxhetit, i cili është miratuar me 30 shtator.

3. Shqyrtimi i Raportit të Punës të Kryetarit të Komunës për vitin 2022;

Nënkryetari – Faleminderit i nderuar kryesues, të nderuar anëtarë të KPF-së. Besoj që ju nuk e keni këtë raport të punës së kryetarit meqenëse është përfunduar dhe dje dhe kërkoj nga Zyra e Kuvendit që t'ju dërgoj në email. Në KPF është paraparë kjo pikë për t'u diskutuar në seancën e rregullt të Kuvendit. Raportet e punës së kryetarit më herët i kemi trajtuar në vitin vijuar, por meqenëse organizatat monitoruese kërkojnë të trajtohen mrenda vitit kalendarik, atëherë kemi vepruar dhe e kemi bërë gati.

Kryesuesi – Atëherë raporti do të jetë gati në seancën e rregullt. Nëse dikush nuk ka ndonjë gjë për të thënë, unë po e vendosi në votim. Kush është për?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e tretë e rendit të ditës.

4. Shqyrtimi i propozim-vendimit për Planin e Punës të Kryetarit të Komunës së Rahovecit për vitin 2023;

Nënkryetari – Para vetes e keni projekt-planin ose draft-planin të qeverisë për vitin 2023. Këtu më gjerësisht janë të prezantuara zotimet e qeverisë komunale, prioritetet e programit qeverisës për vitin 2023, synimet dhe sfidat kryesore të paraqitura gjithnjë për vitin 2023 për të gjitha drejtoritë, 12 që janë.

Kryesuesi – Faleminderit nënkryetar. A ka dikush diçka rreth kësaj pike?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është për?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e 4-të e rendit të ditës.

5. Shqyrtimi i propozim-vendimit për Planin e Punës të Kuvendit Komunal për vitin 2023;

Skender Hamza – Përhëndetje kryesues, nënkryetar, drejtor dhe të gjithë të pranishmit. Projekt-Planin e Punës së Kuvendit e keni para vetës. Ne si sekretari e kemi përgatitur këtë draft-plan, iu kemi dorëzuar juve anëtarëve të KPF-së. Gjithashtu ky projekt-plan është diskutuar në një punëtori, ku poashtu keni qenë të ftuar të gjithë si anëtarë të KPF-së dhe me keqardhje po e them që vetëm Melinda ishte pjesëmarrëse aty. Ju tjerët ndoshta keni patur arsye personale. Aty janë bërë disa propozime, disa ndryshime të muajve etj... Nëse keni ndonjë propozim tani ju këtu, ne përsëri mund të bëjmë ndryshime.

Burim Krasniqi – Pak me humor e kam, mirë kishte me qenë të fliste kryesuesi dhe jo kryetari sepse raporti është i asamblesë komunale dhe jo i ekzekutivit, kryetari raporton për raportet e veta. E dyta; Për sekretarinë e kuvendit; Është mire kur provohet të bëhet punë e mire, por nuk i takon sekretarisë t'i jep vërejtje kuvendarëve për mospjesëmarrje në një tryezë, mundet kryesuesi dhe jo sekretaria e kuvendit. Të kemi kujdes dhe t'i dijmë pozicionet se ku i kemi.

Kryesuesi – Faleminderit, veç sa pata plan të ju them, Skenderi foli për këtë çështje dhe nuk besoj që e ka gabim. Ka qenë organizim i KPF-së dhe është dashur të merrni pjesë, përgjegjësia është individuale. Megjithatë nëse dikush prej anëtarëve ka diçka për të thënë? Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim pikën e pestë, kush është për?... Me shumicë aprovohet edhe kjo pikë e rendit të ditës.

6. Shqyrtimi i propozim-vendimit për Planin e Punës të Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi (KKSB) për vitin 2023;

Nënkryetari – Faleminderit kryesues. E keni planin e punës e Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi. Unë jam anëtarë i këtij plani, jo zyrtarisht, por marr pjesë në secilën mbledhje. Ky plan është bërë në pajtim me KKSB-në, obligimi ligjor është që brenda vitit të mbahen gjashtë seanca. Ne për këtë vit i kemi përfunduar shtatë.

Kryesuesi – Faleminderit nënkryetar. Ky plan votohet nga KKSB, por duhet edhe të kalojë formalisht përmes kuvendit. Po e vendosi në votim për aprovim. Kush është për?... Me shumicë votash aprovohet pika e gjashtë.

7. Shqyrtimi i propozim-vendimit për Planin e Vlerësimit të Rreziqeve nga fatkeqësitë natyrore dhe fatkeqësitë e tjera;

Përparim Krasniqi – Faleminderit. Në video-projektor mund ta shihni. Ky është dokumenti i parë që bëhet në komunë të Rahovecit. Unë jam kryesues i grupit punues (29 persona) për këtë dokument, është shumë voluminoz për këtë arsye nuk kemi mundur t'u bëjmë nga një kopje fizike, por e keni në email përmes linkut.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor. A ka dikush prej anëtarëve të komitetit ndonjë pyetje?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është për?... Me shumicë votash, aprovohet edhe pika e shtatë.

8. Shqyrtimi i propozim-vendimit për Planin e Transportit Rrugor 2022 – 2027;

Përparim Krasniqi – Si drejtori gjatë tërë vitit kemi përgatitur 4 plane, një e kemi kaluar përmes kuvendit (planin për menaxhim të mbeturinave), ndërsa tani i kemi në shqyrtim edhe 3 plane. Ky plan i ka munguar Rahovecit, kërkohet edhe nga granti i performancës dhe nga indikatorët tjerë që kërkohen. Ka qenë në diskutim publik një muaj, e kemi punuar me grupin punues dhe e kemi analizuar-krahasuar me disa komuna që e kanë po të njëjtin.

Kryesuesi – Nëse e ka dikush ndonjë pyetje rreth këtij plani?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është për?... Me shumicë votash aprovohet pika e tetë e rendit të ditës.

9. Shqyrtimi i propozim-vendimit për Planin e Mobilitetit Urban 2022 – 2027;

Përparim Krasniqi – Faleminderit. Ky plan është një dokument strategjik urban shumë me rëndësi. Në planin e mobilitetit që e kemi pasë më herët kanë qenë të kyqur edhe Demos-i, ka kaluar në diskutim publik të cilin e kemi mbajtur jashtë ambienteve të komunës. Nga Burimi kam kërkuar të kyçet në ekspertizën e këtij mobilitetit, por ndoshta nuk i ka ngelur koha të marr pjesë dhe të jep kontribut në këtë drejtim.

Kryesuesi – A ka dikush ndonjë pyetje rreth kësaj pike?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është për?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e nëntë.

10. Shqyrtimi i propozim-vendimit për mbulimin e shpenzimeve të varrimit për vitin 2023;

Nënkryetari – Faleminderit. Në mungesë të drejtorieshës për shëndetësi, po e prezantoj këtë pikë të rendit të ditës. Tradicionalisht kemi kontratë me Bashkësinë Islame. Me 31 vjetor përfundon kjo kontratë dhe e kemi propozim-vendimin për t'ia vazhduar për vitin 2023. Për vitin 2023 është e paraparë një ngritje e shumë, nga 200 sa ishte në 220euro. Me kërkesë të qytetarëve është kërkuar edhe një “letër e zezë” gjatë varrimit, nuk e di pse, nuk i kuptoj shumë parimet fetare, po e kemi vendosur këtë specifikacion. Propozoj që në njërin paragraf të shtohet: Në rast se varroset ndonjë veteran i UÇK-së në Koshare i cili është banor i komunës së Rahovecit, përpos shpenzimeve që janë 220euro, shpenzimet tjera të jenë + 200euro, sepse varri me beton ka një kosto më të madhe. Nëse pajtoheni, është mirë të jetë ky propozim.

Burim Krasniqi – Në seancën e muajit prill nëse nuk gaboj e kemi nxjerrë një vendim për mbulimin e shpenzimeve të varrimit. Më pas në një iftar, kryetari i komunës me bashkësinë islame e ka nënshkruar një memorandum mbi bazën e vendimit të asamblesë. Mund ta ktheni procesverbalin, aty e keni që edhe atëherë e kam propozuar letrën e zezë të jetë pjesë e kësaj. Keni thënë nuk bën sepse bashkësia islame nuk e pranon, a e keni diskutuar me bashkësinë islame këtë çështje dhe pse tash bën, e më herët jo? Është mirë me pa krahasimin e vendimit sepse më herë e kemi pas +10euro për afishe, e tash nuk është. Kam kërkuar t'i heqim afishet, ta vendosim letrën e zezë. Keni thënë nuk bën, bashkësia islame në kuptimin fetar nuk lejon.

Nënkryetari – Burimi ka të drejtë. Unë nuk i kuptoj ritet fetare. Jemi të fesë Islame, por nuk e praktikoj fenë. I kemi c ituar fjalët e kryetarit të Bashkësisë Ismale. E kemi diskutuar pikërisht letrën e zezë, gjatë bisedës kanë thënë që nuk është “haram”, meqenëse nuk është kështu, ne e kemi vendosur letrën e zezë. Sa i përket afisheve, asnjë familje që ka patur rast vdekje, nuk i ka marrur afishet. Meqenëse nuk është praktikuar kjo, e kemi hequr.

Burim Krasniqi – Mos të keqkuptohem, sepse nuk jam kundër vendimit për mbulim të shpenzimeve të varrimit. Sa i përket asaj që the për propozim të shtimit të një paragrafi në një pike. Mendoj që kryetari i komunës këtë punë mund ta bëjë kur të don sepse e katë drejtën deri në 2000euro të jep subvencion për nevojë ose përkrahje të caktuar.

Nënkryetari – Mendoj që është shumë mire që të përfshihet si pike. Ndërsa kryetari ka gjithmonë të drejtën e asaj, është një luftëtar bukur i madh meqenëse ka marrë pjesë në luftë dhe poashtu i përkrahë çdo herë familjet e ushtarëve, v eteranëve dhe martirëve.

Kryesuesi – Faleminiderit. Atëherë për seancën e rregullt, me ndihmën e zyrës ligjore, vendimi mund të përmirësohet. Nëse dikush prej anëtarëve nuk ka diçka për të thënë?... E vendosim në votim si të tillë, në seancë të rregullt do të vie rre një nen shtesë, kush është për?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e 10-të.

11. Shqyrtimi i propozim-vendimit për miratimin e simbolit përkujtimor të gjenocidit në Kosovë;

Nënkryetari – E kemi paraparë si pike të rendit të ditës dhe besoj që shumica e kuvendeve komunale e kanë në rend d ite. Kështuqë, lulëkuqja me katër petale le të jetë simbol unik përkujtimor i gjenocidit në Kosovë.

Kryesuesi – Faleminiderit nënkryetar. A ka dikush ndonjë koment?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është për?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e 11-të.

12. Shqyrtimi i propozim-vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr.263/22, i datës: 25.01.2022, për themelimin e Komitetit për Politikë dhe Financa;

Nënkryetari – Meqenëse ne kemi lëvizje; Një asambleiste (shefe e grupit) është emëruar drejtëreshë për Mbrojtje dhe Shpëtim dhe do të plotësohet numri i anëtarëve të KPF-së në kuvend. Përsëri pozita i takon AAK-së, përsëri kuota gjinore do të respektohe, në seancë të kuvendit do ta japim emrin.

Kryesuesi – Faleminiderit nënkryetar. Dikush prej anëtarëve ndonjë koment?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim pikën e 12 të rendit të ditës. Kush është për?... Me shumicë votash aprovohet edhe kjo pikë.

13. Shqyrtimi propozim-vendimit për shpalljen në interes të përgjithshëm të parcelës në Xërxë P-01041-1 – Xërxë;

Afrim Oruqi – Faleminderit kryesues. I nderuar nënkryetar, kolegë drejtor, anëtarë të KPF-së. Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe Statutit të komunës së Rahovecit, kryetari i komunës ju propozon që të shpallet me interes ë përgjithshëm P-01041-1 në zone kadastrale në Xërxë me sipërfaqe të përgjithshme 14 ari e 72m katror me kulturë e klasit të katërt në pronësi të Hysni Vehbi Thaqi nga fshati Xërxë. Qëllimi i shpalljes së interesit të përgjithshëm publik të parcelës, është këmbimi i pronës private me prone komunale.

Burim Krasniqi – Mendoj që në seancën e rregullt duhet me qenë raporti i komisionit profesional që e ka bërë vlerësimin e shkëmbimit të pronave. Të ia bashkangjiteti propozim vendimit edhe këtë informatë, meqenëse asambleja e voton.

Afrim Oruqi – Sipas ligjit dhe akteve tjera nënligjore që e rregullojnë këtë fushë, raporti i vlerësimit të pronave vie në fazën e dytë, fillimisht parashihet interesi i përgjithshëm, pastaj vendimi për interes të përgjithshëm shkon në MAPL, më pas kthehet ligjshmëria dhe kur e marrim vendimin për interes të përgjithshëm në një seancë tjetër para jush, propozojmë vendimin për këmbim dhe i bashkangjitet raporti i komisionit që themelohet nga kryetari i komunës, jo në këtë fazë por në fazën e ardhshme tjetër.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor. A ka dikush tjetër ndonjë pyetje?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është për?... Me shumicë votash aprovohet edhe pika e 13-të e rendit të ditës.

14. Shqyrtimi i vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 338/22 i datës 29.06.2022 për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër;

Erhan Morina – Faleminderit kryesues. I nderuar nënkryetar, drejtorë të drejtorive, anëtarë të KPF-së. Para jush keni materialin për plotësim-ndryshimin e vendimit të datës 29.06.2022 me nr.338/22, nga dy vendim do të hiqen pikat 2.1 / 2.5 / 2.7 / 2.8, ndërsa pikat tjera do të mbesin të pandryshuara. Arsyeja për plotësim-ndryshimin e këtij vendimi është për shkak të këmbimit të parcelave – pronave në terren dhe ne si sponsorizues të kësaj pike, kërkojmë që këtë vendim ta kalojmë në seancën e rregullt të kuvendit.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor, po e vendosim në votim këtë pike, nëse nuk ka dikush tjetër ndonjë pyetje?... Kush është për?... Me shumicë votash aprovet pika e 14-të e rendit të ditës.

15. Shqyrtimi i vendimit për ndryshimin dhe plotësimin e vendimit 01 Nr. 341/22 i datës 29.06.2022 për formimin e komisionit për zbatimin e procedurave dhe vlerësimin e ofertave të dhënies në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të komunës;

Erhan Morina – Fakti që po ndërron vendimi paraprak për dhënien në shfrytëzim të pronave, duhet të ndryshohet edhe vendimi për krijimin e komisionit për vlerësimin e ofertave për këtë vendim.]

Kryesuesi – Nëse dikush prej anëtarëve nuk ka ndonjë pyetje rreth kësaj pike, po e vendosim në votim. Kush është për?... Me shumicë votash aprovet edhe pika e 15-të e rendit të ditës.

16. Shqyrtimi raportit mbi regjistrimin dhe vlerësimin e dëmeve në amvisëri, ekonomi familjare dhe biznese, të shkaktuara nga vërshimet e shiut me datë: 17 shtator 2022.

Erhan Morina – Ndoshta pak me vonesë, por kemi kërkuar që të futet në KPF kjo pikë e rendit të ditës, është kërkesë e AME-së që ne ta zbatojmë rregulloren që është në fuqi, rregullorja me nr 17/2015 e cila na obligon që këtë raport ta fusim në kuvend për miratim. Ftoj anëtarët e KPF-së që poashtu edhe këtë pikë të rendit të ditës ta kalojnë për seancën e rregullt të kuvendit.

Kryesuesi – Faleminderit drejtor. A ka dikush ndonjë pyetje për këtë pikë? Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim, kush është për?... Me shumicë votash aprovet edhe pika e 16-të.

17. Të ndryshme;

Kryesuesi – Nëse dikush prej anëtarëve ka ndonjë kërkesë, apo ndonjë çështje për diskutim ose propozim për seancën e rregullt.

Burim Krasniqi – Faleminderit kryesues. Mendoj që, në fund është mirë ta kemi një informatë për gjendjen në terren pas reshjeve të fundit që kanë ndodhur, të jemi në dijeni rreth gjendjes dhe ta kemi një vlerësim prej ekzekutivit.


Kryesuesi – Faleminderit Burim. Besoj që ekzekutivi do ta merr parasysh këtë kërkesë dhe do t'na shpalos neve para kuvendit raportin.

Nënkryetari – Faleminderit kryesues. Lidhur me kërkesën e Burimit; Ndoshta kjo kërkesë nuk mund të përcjellet me kohë sepse duhet të përgatitet si informatë, kështu që në momentin që është gati në koordinim me drejtorin e Shërbimeve Publike dhe atë të Bujqësisë do t'ju dërgohet në email.

Kryesuesi – Faleminderit. Dikush tjetër ndonjë çështje?... Nëse jo, atëherë po e përmbylлим mbledhjen e 11-të të KPF-së. Shihemi në seancën e rregullt. Një njoftim tjetër; Sot e kemi edhe seancën e jashtëzakonshme prej orës 12:00, për shqyrtimin e propozim-vendimit për daljen në konsultim public të PZHK-së.

Mbledhja përfundoi: 11:05

Procesmbajtësi;


Burim Krasniqi

